



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVA QEVERIA E KOSOVËS - VLADA KOSOVA - GOVERNMENT OF KOSOVA ZYRA E KRYEMINISTRIT - URED PREMIJERA - OFFICE OF THE PRIME MINISTER SEKTORI I ARKIVËS - SEKTOR ARCHIVE - ARCHIVE SECTOR			
Njësia Org. Org.ance Org. Unit	02.10	Nr. Prot. Broj Prot. Prot. No.:	2012
Nr. i faqeve br. strana No. pages	10	Data: Datum: Date:	27/07/2015
Prishtinë / a			

REPUBLIKA E KOSOVËS – PRESIDENTI
REPUBLIC OF KOSOVO – THE PRESIDENT
REPUBLIKA KOSOVO – PRESEDNIK

DEKRET PËR RATIFIKIM TË MARRËVESHJES
NDËRKOMBËTARE

Duke u bazuar në nenin 18, paragrafi 2 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, në nenin 10 paragrafi 4 të Ligjit Nr. 04/L-052 për Marrëveshjet Ndërkombëtare si dhe në nenin 4, paragrafi 3 të Ligjit Nr. 03/L-044 për Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe Shërbimin Diplomatik:

D e k r e t o j

Ratifikimin e Marrëveshjes për Bashkëpunim Gjyqësor në Çështjet Penale, në mes të Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe Qeverisë së Republikës Federale të Gjermanisë, e nënshkruar në Berlin, më 29 qershor 2015 dhe të pranuar në Zyrën e Presidentit të Republikës së Kosovës me datë 7 korrik 2015.

Marrëveshja e ratifikuar i dërgohet Kuvendit të Republikës së Kosovës për njoftim, në përputhje me nenin 18, paragrafi 3 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës.

Marrëveshja e ratifikuar hyn në fuqi në datën e shpalljes në Gazetën Zyrtare.

Nr. i Dekretit: DMN – 017 – 2015.

Prishtinë, më 24 korrik 2015.



Atifete Jahjaga
Presidente e Republikës së Kosovës

Marrëveshje

ndërmjet

Qeverisë së Republikës së Kosovës

dhe

Qeverisë së Republikës Federale të Gjermanisë

për

Bashkëpunim Gjyqësor në Çështjet Penale

Qeveria e Republikës së Kosovës
dhe
Qeveria e Republikës Federale të Gjermanisë,

me dëshirën për të përmirësuar bashkëpunimin gjyqësor të të dyja Palëve në hetimin dhe ndjekjen e veprave penale, ekstradimin e personave me qëllim të ndjekjes penale ose ekzekutimit të dënimeve, si dhe transferimin e personave të dënuar, ekzekutimin e dënimeve me heqje lirie dhe konfiskimin e pasurisë së fituar me vepër penale;

me dëshirën për të krijuar një bazë ligjore dypalëshe për një bashkëpunim të tillë sipas kushteve të konventave ekzistuese të Këshillit të Evropës;

janë pajtuar si vijon:

Neni 1

Ndihma Juridike e Ndërsjellë

(1) Palët do t'i ofrojnë njëra-tjetrës ndihmë juridike të ndërsjellë në të gjitha procedurat lidhur me veprat penale, ndjekja e të cilave në kohën e kërkesës për ndihmë bie brenda juridiksionit të autoriteteve gjyqësore të Palës kërkuese.

(2) Ndihma juridike e ndërsjellë po ashtu mund të ofrohet në procedurat lidhur me veprat, të cilat sipas legjislacionit vendor të Palës kërkuese ose të Palës së kërkuar konsiderohen nga autoritetet administrative si shkelje të dispozitave ligjore dhe dënohen me gjobë, në rastet kur kundërshtimi tek gjykata penale është i mundur.

(3) Për këtë qëllim, Palët në marrëdhëniet e tyre dypalëshe do të zbatojnë nenet 1 deri në 10, nenin 11 paragrafët 1 dhe 3, nenet 12 deri në 14, 17, dhe 19 deri 22 të Konventës

Evropiane të datës 20 prill 1959 për Ndihmë Juridike të Ndërsjellë në Çështjet Penale si dhe nenet 1 deri 4 të Protokollit Shtesë të datës 17 mars 1978.

(4) Neni 11 paragrafi 2 i Konventës Evropiane për Ndihmë Juridike të Ndërsjellë në Çështjet Penale do të zbatohet me kusht që, në rast se zbatohet kushti nga Neni 11 paragrafi 1 i Konventës Evropiane për Ndihmë Juridike të Ndërsjellë në Çështjet Penale, kalimi transit i personit në fjalë përmes territorit në fjalë mund të miratohet në bazë të një kërkesë drejtuar Autoritetit Qendror. Kalimi transit mund të refuzohet nëse personi është shtetas i Palës së kërkuar. Në rast se avioni nuk është planifikuar të aterojë në shtetin e transitit, nuk është e nevojshme të parashtrohet kërkesë për kalim transit, përveç nëse bëhet fjalë për një avion ushtarak.

(5) Në rast se Republika Federale e Gjermanisë është Pala e kërkuar, dispozitat e Konventës dhe Protokollit, të specifikuar në paragrafin 3, zbatohen sipas kushteve të përcaktuara në shtojcën I.

(6) Në rast se Republika e Kosovës është Pala e kërkuar, dispozitat e Konventës dhe Protokollit, të specifikuar në paragrafin 3, zbatohen sipas kushteve të përcaktuara në shtojcën II.

(7) Palët, me qëllim të zbatimit të dispozitave të Konventës dhe Protokollit, të specifikuar në paragrafin 3, do të njohin si autoritete gjyqësore autoritetet e specifikuar në shtojcën III.

Neni 2
Ekstradimi

(1) Palët marrin përsipër t'i dorëzojnë njëra-tjetrës personat, kundër të cilëve autoritetet kompetente të Palës kërkuese zhvillojnë ndjekjen penale për një vepër penale ose të cilët janë të kërkuar nga autoritetet e lartpërmendura për ekzekutimin e dënimit me një sanksion apo masë sigurimi.

(2) Për këtë qëllim, Palët në marrëdhëniet e tyre dypalëshe do të zbatojnë nenin 2 paragrafët 1 dhe 2 dhe nenet 3 deri në 22, 24 dhe 25 të Konventës Evropiane për Ekstradim të datës 13 dhjetor 1957 si dhe nenet 1 deri 4 të Protokollit të Dytë Shtesë të datës 17 mars 1978, përveç nëse është paraparë ndryshe me këtë Marrëveshje.

(3) Neni 18 Paragrafi 1 i Konventës Evropiane për Ekstradim nuk do të zbatohet. Neni 10 i Konventës Evropiane për Ekstradim do të zbatohet me kusht që ekstradimi nuk do të lejohet nga Pala e kërkuar e cila gjithashtu mund të ushtrojë juridiksionin e saj, nëse sipas legjislacionit të saj vepra penale ose ekzekutimi i dënimit është parashkruar apo përjashtohet në bazë të një ligji për amnisti. Neni 21 i Konventës Evropiane për Ekstradim do të zbatohet me kusht që kalimi transit i një personi,, i cili duhet ekstraduar nga një shtet i tretë nëpër territorin e një Pale në territorin e Palës tjetër, në përgjigje të një kërkesë, e cila duhet t'i drejtohet Autoritetit Qendror, mund të miratohet. Në rast se avioni nuk është planifikuar të aterojë në shtetin e transitit, nuk është e nevojshme të parashtrohet kërkesë për kalim transit, përveç nëse bëhet fjalë për një avion ushtarak.

(4) Në rast se Republika Federale e Gjermanisë është Pala e kërkuar, dispozitat e Konventës dhe Protokollit të specifikuar në paragrafin 2 zbatohen në bazë të kushteve të përcaktuara në shtojcën IV.

(5) Në rast se Republika e Kosovës është Pala e kërkuar, dispozitat e Konventës dhe Protokollit të specifikuar në paragrafin 2 zbatohen në bazë të kushteve të përcaktuara në shtojcën V.

Bashkëpunimi Gjyqësor në Luftën kundër Terrorizmit

Me qëllim të ndihmës juridike të ndërsjellë në çështjet penale si dhe ekstradimit, Palët në marrëdhëniet e tyre dypalëshe do të zbatojnë nenet 1 deri 5, 7 dhe 8 të Konventës Evropiane të datës 27 janar 1977 mbi Luftimin e Terrorizmit, në versionin e ndryshuar me nenet 1 deri 4 të Protokollit Shtesë të datës 15 Maj 2003.

Neni 4

Bashkëpunimi Gjyqësor me Qëllim të Kontrollimit, Sekuestrimit dhe Konfiskimit të Pasurisë së Fituar me Vepër Penale

(1) Palët do të bashkëpunojnë me njëra-tjetrën në mënyrë sa më të gjerë, në përputhje me legjislacionin vendor, me qëllim të hetimeve dhe procedurave që synojnë konfiskimin e mjeteve të përdorura për kryerjen e veprës penale dhe të pasurisë së fituar me vepër penale.

(2) Për këtë qëllim, Palët në marrëdhëniet e tyre dypalëshe do të zbatojnë dispozitat e përcaktuara në nenet 1, 8 deri 22 dhe 26 deri 35 të Konventës së datës 8 nëntor 1990 mbi Pastrimin e Parave dhe mbi Kërkimin, Sekuestrimin dhe Konfiskimin e Pasurisë së Fituar me Vepër Penale.

Neni 5

Transferimi i Personave të Dënuar, Ekzekutimi i Dënimeve

(1) Palët marrin përsipër t'i ofrojnë njëra-tjetrës bashkëpunim sa më të gjerë në lidhje me transferimin e personave të dënuar dhe ekzekutimin e dënimeve.

(2) Për këtë qëllim, Palët në marrëdhëniet e tyre dypalëshe, do të zbatojnë nenet 1 deri 4 dhe 6 deri 15 si dhe nenin 17, paragrafët 4 dhe 5 të Konventës së datës 21 mars 1983 mbi

Transferimin e Personave të Dënuar si dhe nenet 1 deri 3 të Protokollit Shtesë të datës 18 dhjetor 1997.

(3) Neni 16 i Konventës mbi Transferimin e Personave të Dënuar do të zbatohet me kusht që transferimi i personit, i cili do të transferohet nga një shtet i tretë nëpër territorin e një Pale në territorin e Palës tjetër mund të miratohet në bazë të kërkesës, e cila duhet t'i drejtohet Autoritetit Qendror. Në rast se avioni nuk është planifikuar të aterojë në shtetin e transitit, nuk është e nevojshme të parashtrahet kërkesë për kalim transit, përveç nëse bëhet fjalë për një avion ushtarak.

(4) Në rast të Republikës Federale të Gjermanisë, dispozitat e Konventës dhe Protokollit të specifikuar në paragrafin 2 zbatohen në bazë të kushteve të përcaktuara në shtojcën VI.

(5) Në rast të Republikës së Kosovës, dispozitat e Konventës dhe Protokollit të specifikuar në paragrafin 2 zbatohen në bazë të kushteve të përcaktuara në shtojcën VII.

Neni 6 Konfidencialiteti

(1) Pala e kërkuar, pas konsultimeve me Palën kërkuese, mund të kërkojë që informacionet apo dëshmitë e ofruara ose burimi i informacioneve apo të dëshmimeve të tilla të mbahen konfidenciale, të zbulohen ose të përdoren vetëm sipas kushteve që mund të përcaktojnë ajo.

(2) Pala kërkuese mund të kërkojë që kërkesa, përmbajtja e saj, dokumentet mbështetëse dhe çdo veprim i ndërmarrë në bazë të kërkesës të mbahen konfidenciale. Nëse kërkesa nuk mund të plotësohet pa u hequr konfidencialiteti, Pala e kërkuar do të informojë për këtë Palën kërkuese para plotësimit të kërkesës, dhe kjo e fundit më pas do ta përcaktojë nëse kërkesa megjithatë duhet të plotësohet.

Neni 7 Kufizimi i Përdorimit

(1) Pala kërkuese nuk do të përdorë informacionet ose dëshmitë e ofruara për qëllime të tjera përveç atyre të përcaktuara në kërkesë, apo për të justifikuar shqiptimin e një dënimi më të rëndë sesa dënimi maksimal i deklaruar në kërkesë, pa pëlqimin paraprak të Palës së kërkuar.

(2) Informacionet ose dëshmitë e transmetuara në bazë të kësaj Marrëveshje mund të përdoren pa miratimin paraprak në përputhje me kushtet e përcaktuara nga Pala e kërkuar gjatë ofrimit të ndihmës juridike për qëllimet e mëposhtme:

1. për procedura gjyqësore jo-penale dhe procedura administrative, të cilat janë drejtpërdrejt të ndërlidhura me përdorimin, për të cilin informacionet ose dëshmitë janë kërkuar fillimisht, dhe
2. për të shmangur rreziqet serioze dhe të drejtpërdrejtë për sigurinë publike.

(3) Përdorimi i informacioneve ose dëshmive për qëllime të tjera kërkon miratim paraprak të Palës që transmeton informacionet ose dëshmitë.

Neni 8 Mbrojtja e të Dhënave Personale

(1) Termi “të dhëna personale”, i quajtur më poshtë “të dhënat”, nënkupton çdo informacion në lidhje me një person fizik të identifikuar ose të identifikueshëm.

(2) Neni 7 do të zbatohet edhe për transferimin dhe përdorimin e të dhënave.

(3) Në bazë të dispozitave të legjislacionit vendor të secilës Palë dhe duke marrë në konsideratë Konventën e datës 28 janar 1981 për Mbrojtjen e Njeriut në Lidhje me

Përpunimin Automatik të të Dhënave Personale,, si dhe Protokollin Shtesë të datës 8 nëntor 2001, dispozitat e mëposhtme do të zbatohen për transmetimin dhe përdorimin e të dhënave:

1. Pala, e cila ka pranuar të dhënat, me kërkesë do të identifikojë të dhënat e pranuar dhe do të informojë Palën transmetuese për përdorimin e të dhënave dhe rezultatet e arritura nga kjo;
2. palët do të trajtojnë me kujdes të dhënat e transmetuara në bazë të kësaj Marrëveshjeje dhe do t'i kushtojnë vëmendje të veçantë saktësisë dhe kompletimit të të dhënave në fjalë. Vetëm të dhënat që ndërlidhen me kërkesën mund të transmetohen. Nëse rezulton se të dhënat e transmetuara janë të pasakta apo se janë transmetuar të dhëna që nuk duhet të transmetoheshin, pala që ka pranuar këto të dhëna duhet të njoftohet pa vonesë. Pala që ka pranuar të dhënat do të mënjanojë ose të korrigjojë gabimet ose edhe të fshijë të dhënat;
3. palët do të mbajnë shënime në një formë të përshtatshme në lidhje me transmetimin dhe pranimin e të dhënave;
4. palët do të marrin të gjitha masat e nevojshme për të ofruar mbrojtjen efektive të të dhënave të transmetuara kundër qasjes, ndryshimit dhe publikimit të paautorizuar;
5. personi i interesuar do të informohet me kërkesë për të dhënat ekzistuese në lidhje me të, si dhe për qëllimin e përdorimit dhe të arkivimit të tyre. Nuk ekziston asnjë detyrim për të dhënë informacione, nëse nga peshimi i interesave del se interesi publik për mosdhënien e informacionit peshon më shumë sesa interesi i personit në fjalë për t'u informuar. Përveç kësaj, e drejta e personit të interesuar për t'u informuar me të dhënat ekzistuese në lidhje me të, do të rregullohet sipas legjislacionit vendor të Palës në territorin e së cilës informacioni është kërkuar;

6. nëse, si rezultat i transmetimeve në kuadër të shkëmbimit të të dhënave sipas kësaj Marrëveshjeje, një personi shkaktohen dëme të paligjshme, Pala pranuese, në bazë të legjislacionit vendor të saj, do të jetë përgjegjëse për atë person. Pala pranuese në mbrojtje kundrejt personit të dëmtuar nuk mund të mbajë qëndrimin se dëmi ishte shkaktuar nga Pala transmetuese. Nëse Pala pranuese paguan kompensim për dëmin e shkaktuar nga përdorimi i të dhënave të pasakta të marra nga Pala transmetuese, Pala transmetuese do të kompensojë Palën pranuese me një kompensim të tillë, në përputhje me dispozitat përkatëse të legjislacionit vendor;
7. nëse nuk parashikohet ndryshe në raste të veçanta, Palët - në bazë të legjislacionit vendor- marrin përsipër detyrimin për të fshirë të dhënat e transmetuara në momentin që ato nuk janë më të nevojshme për qëllimet e përcaktuara në kërkesën fillestare ose për qëllimet për të cilat ato janë përdorur ligjërisht në bazë të Nenit 7 paragraf 2, pikat 1 dhe 2 të kësaj Marrëveshjeje.

Neni 9 Legalizimi

Dokumentet, shënimet ose objektet e transmetuara në bazë të kësaj Marrëveshjeje nuk do të kërkojnë ndonjë formë të legalizimit, përveç rasteve kur kjo kërkohet nga Konventat dhe Protokollet e përmendura në nenet 1 deri 5 apo kur kjo kërkohet në një rast të veçantë.

Neni 10 Gjuha

Kërkesat dhe dokumentet përcjellëse do të dorëzohen së bashku me një përkthim në gjuhën shqipe apo serbe kur kërkesa i drejtohet Republikës së Kosovës, dhe një përkthim në gjuhën gjermane në rast se kërkesa i drejtohet Republikës Federale të Gjermanisë..

Neni 11

Autoriteti Qendror - Transmetimi i Kërkesave

- (1) Autoritetet Qendrore do të transmetojnë dhe të pranojnë të gjitha kërkesat për qëllimet e kësaj Marrëveshje.
- (2) Autoriteti Qendror për Republikën e Kosovës do të jetë Ministria e Drejtësisë.
- (3) Autoriteti Qendror për Republikën Federale të Gjermanisë do të jetë Zyra Federale e Drejtësisë (Bundesamt für Justiz). Në rastin e kërkesave sipas nenit 4 paragrafi 2, Zyra Federale Kriminale (Bundeskriminalamt) është caktuar Autoritet Qendror përgjegjës për transmetimin e kërkesave tek autoritetet përgjegjëse për ekzekutimin e tyre.
- (4) Në rast të ndonjë ndryshimi, Palët do të njoftojnë njëra-tjetrën.
- (5) Në raste urgjente, transmetimi i kërkesave për ndihmë juridike mund të bëhet me ndërmjetësim të Organizatës Ndërkombëtare të Policisë Kriminale (Interpol).
- (6) Kërkesa duhet të parashtrohet me shkrim, megjithëse në raste urgjente Autoritetet Qendrore mund të përdorin një formë tjetër. Nëse kërkesa nuk paraqitet me shkrim, ajo duhet të konfirmohet me shkrim brenda 18 ditëve përveç nëse Autoriteti Qendror i shtetit të kërkuar shprehet dakord me një rregullim tjetër.
- (7) Autoriteti kërkues do të informohet pa vonesë për rezultatin e kërkesës së tij.

Neni 12

Zgjidhja e mosmarrëveshjeve

Çdo mosmarrëveshje lidhur me interpretimin, përdorimin ose zbatimin e kësaj Marrëveshjeje do të zgjidhet në rrugë diplomatike.

Neni 13

Shtojcat

Shtojcat I - VII përbëjnë pjesë integrale të kësaj Marrëveshjeje. Shtojca III mund të ndryshohet përmes shkëmbimit të Notave Verbale.

Neni 14

Hyrja në Fuqi, Pezullimi dhe Ndërprerja


(1) Kjo Marrëveshje hyn në fuqi 30 ditë pas datës kur Palët njoftojnë njëra-tjetrën me Notë Verbale se kushtet sipas legjislacionit vendor për hyrjen e saj në fuqi janë përmbushur. Përcaktuese është dita e marrjes së njoftimit të fundit.

(2) Kjo Marrëveshje do të jetë në fuqi për një kohë të pakufizuar. Secila nga Palët mund të pezullojë ose ndërprejë këtë Marrëveshje në çdo kohë duke e njoftuar Palën tjetër me Notë Verbale,, në veçanti nëse një Marrëveshje ndërmjet Bashkimit Evropian dhe Republikës së Kosovës, e cila rregullon të njëjtën çështje si kjo Marrëveshje, do të hyjë në fuqi.. Pezullimi do të hyjë në fuqi pas marrjes së njoftimit përkatës. Në rast të ndërprerjes, Marrëveshja do të shfuqizohet gjashtë muaj pas marrjes së njoftimit përkatës.


Bërë në Berlin më 29.6.2015 në dy kopje origjinale në gjuhën shqipe, serbe, gjermane dhe angleze, duke pasur secili tekst fuqi të barabartë.. Në rast të ndonjë ndryshimi në

interpretim të teksteve në gjuhën shqipe, serbe dhe gjermane, teksti në gjuhën angleze është përcaktues.

Për Qeverinë e Republikës së Kosovës

A handwritten signature in black ink, consisting of a large, stylized initial 'M' followed by several loops and a horizontal line.

Për Qeverinë e Republikës Federale të Gjermanisë

Two handwritten signatures in black ink. The top signature is a long, horizontal line with a large initial 'J'. The bottom signature is a more complex, cursive signature with several loops.

SHTOJCA I

Kushtet e referuara në nenin 1, paragrafi 5

Duke iu referuar deklarimeve dhe kushtëzimeve të bëra gjegjësisht të shfaqura nga Republika Federale e Gjermanisë lidhur me Konventën Evropiane të datës 20 prill 1959 për Ndihmë të Ndërsjellë në Çështje Penale dhe me Protokollin e datës 17 mars 1978, në rast se Republika Federale e Gjermanisë është Pala e kërkuar, zbatohen dispozitat e Konventës dhe Protokollit të specifikuar në Nenin 1, paragrafi 3, në kushtet e mëposhtme:

1. Bastisja dhe sekuestrimi i pasurisë lejohet vetëm nëse janë plotësuar kushtet e nenit 5, paragrafi 1 (a) dhe (c) të Konventës Evropiane mbi Ndihmën e Ndërsjellë në Çështjet Penale.
2. Një kërkesë për dorëzimin e një letërthirrjeje për një person të akuzuar (Neni 7 i Konventës Evropiane për Ndihmë të Ndërsjellë në Çështjet Penale), i cili ndodhet në territorin e Republikës Federale të Gjermanisë, në parim do të plotësohet vetëm nëse autoritetet Gjermane e kanë marrë kërkesën në fjalë më së voni një muaj para datës së caktuar për paraqitjen e personit të akuzuar.
3. Transferimi i një dëshmitari do të refuzohet në të gjitha rastet e renditura në nenin 11, paragrafi 1, fjalia e dytë, të Konventës Evropiane për Ndihmë të Ndërsjellë në Çështje Penale. Në rastet e renditura në Nenin 1 paragrafi 4, transferimi do të refuzohet në qoftë se dëshmitari është shtetas Gjerman. Kur kalimi transit kryhet në rrugë ajrore, do të kërkohet garancia që personi i transferuar, në bazë të fakteve të njohura për Palën kërkuese dhe dokumentet në posedim të saj, nuk ka shtetësinë gjermane dhe nuk pretendon një status të tillë.

4. Lidhur me Nenin 2 të Protokollit Shtesë të Konventës Evropiane për Ndihmë të Ndërsjellë në Çështje Penale, Republika Federale e Gjermanisë në përputhje me nenin 8 paragrafin 2 (a) të Protokollit Shtesë , rezervon të drejtën që plotësimin e kërkesave për ndihmë juridike të çdo lloji lidhur me procedurat për raste të shkeljes së dispozitave, që rregullojnë transferimin ndërkombëtar të kapitalit dhe pagesave, ta kushtëzojë me dënueshmërinë sipas së drejtës gjermane të veprës penale, e cila përbën bazën e kërkesës për ndihme juridike, ose me dënueshmërinë e mundshme pas konvertimit analog të fakteve.

5. Lidhur me Nenin 2 të Protokollit Shtesë të Konventës Evropiane për Ndihmë Juridike të Ndërsjellë në Çështje Penale, Republika Federale e Gjermanisë, në përputhje me nenin 8 paragrafi 2 (a) të Protokollit Shtesë të Konventës Evropiane për Ndihmë Juridike të Ndërsjellë në Çështje Penale, rezervon të drejtën që plotësimin e kërkesave për ndihme juridike lidhur me bastisje ose sekuestrim të pasurisë në lidhje me shkelje të tjera fiskale ta kushtëzojë me dënueshmërinë edhe sipas së drejtës gjermane të veprës penale, e cila përbën bazën e kërkesës për ndihme juridike, ose me dënueshmërinë e mundshme pas konvertimit analog të fakteve.

SHTOJCA II

Kushtet sipas nenit 1, paragrafi 5

Në rast se Republika e Kosovës është Pala e kërkuar, dispozitat e Konventës Evropiane të datës 20 prill 1959 për Ndihmë të Ndërsjellë në Çështje Penale dhe Protokollin i datës 17 mars 1978, të specifikuara në nenin 1, paragraf 3, zbatohen në kushtet e mëposhtme:

1. Bastisja dhe sekuestrimi i pasurisë lejohet vetëm nëse janë plotësuar kushtet e nenit 5, paragraf 1 (a) dhe (c) të Konventës Evropiane për Ndihmë të Ndërsjellë në Çështje Penale.
2. Kërkesa për dorëzimin e një letërthirrjeje për një person të akuzuar (Neni 7 i Konventës Evropiane për Ndihmë të Ndërsjellë në Çështjet Penale), i cili ndodhet në territorin e Republikës së Kosovës, në parim, do të plotësohet vetëm nëse Ministria e Drejtësisë së Republikës së Kosovës e ka marrë kërkesën në fjalë më së voni 45 ditë para datës së caktuar për paraqitjen e personit të akuzuar.
3. Transferimi i një dëshmitari do të refuzohet në të gjitha rastet e renditura në nenin 11, paragraf 1, fjalia e dytë, të Konventës Evropiane për Ndihmë të Ndërsjellë në Çështjet Penale.
4. Lidhur me Nenin 2 të Protokollit Shtesë të Konventës Evropiane për Ndihmë të Ndërsjellë në Çështjet Penale, Republika e Kosovës rezervon të drejtën që plotësimin e kërkesave për ndihme juridike lidhur me bastisje ose sekuestrim të pasurisë në lidhje me shkelje të tjera fiskale ta kushtëzojë me dënueshmërinë edhe sipas së drejtës kosovare të veprës penale, e cila përbën bazën e kërkesës për ndihme juridike, ose me dënueshmërinë e mundshme pas konvertimit analog të fakteve.

SHTOJCA III

Lista e autoriteteve sipas nenit 1 paragrafi 7

Me qëllim të zbatimit të dispozitave të Konventës dhe Protokollit, të specifikuara në nenin 1 paragraf 3, Palët do të njohin si autoritete kompetente dikasterët e mëposhtëm:

1. në Republikën e Kosovës:

- Ministria e Drejtësisë;
- Gjykata Supreme;
- Gjykata e Apelit;
- Gjykatat Themelore;
- Prokuroria Shtetërore e Republikës së Kosovës ;
- Prokuroria Speciale e Republikës së Kosovës ;
- Prokuroria e Apelit;
- Prokuroritë Themelore;

2. në Republikën Federale të Gjermanisë:

- Ministria Federale e Drejtësisë dhe për Mbrojtjen e Konsumatorëve (Bundesministerium der Justiz und für Verbraucherschutz), Berlin;
- Gjykata Federale e Drejtësisë (Bundesgerichtshof), Karlsruhe;
- Prokurori i Përgjithshëm Federal pranë Gjykatës Federale të Drejtësisë (Generalbundesanwalt beim Bundesgerichtshof), Karlsruhe;
- Zyra Federale e Drejtësisë (Bundesamt für Justiz), Bonn;
- Ministria e Drejtësisë e Landit Baden-Wuerttemberg (Justizministerium Baden-Württemberg), Stuttgart;

- Ministria e Drejtësisë dhe për Mbrojtjen e Konsumatorëve e Shtetit Bavarez (Bayerisches Staatsministerium der Justiz und für Verbraucherschutz), München;
- Departamenti i Senatit për Drejtësi dhe Mbrojtje të Konsumatorëve (Senatsverwaltung für Justiz und Verbraucherschutz), Berlin;
- Ministria e Drejtësisë e Landit Brandenburg (Ministerium der Justiz des Landes Brandenburg), Potsdam;
- Senatori për Drejtësi dhe Kushtetutë i Qytetit të Lirë Hanseatik të Bremenit (Senator für Justiz und Verfassung der Freien Hansestadt Bremen), Bremen ;
- Dikasteri për Drejtësi dhe Barazi i Qytetit të Lirë dhe Hanseatik të Hamburgut (Behörde für Justiz und Gleichstellung der Freien und Hansestadt Hamburg);
- Ministria e Drejtësisë, Integritit dhe Çështjeve Evropiane e Landit Hessen (Hessisches Ministerium der Justiz, für Integration und Europa), Wiesbaden;
- Ministria e Drejtësisë e Landit Mecklenburg-Vorpommern (Justizministerium Mecklenburg-Vorpommern), Schwerin;
- Ministria e Drejtësisë e Landit Saksonia e Poshtme (Niedersächsisches Justizministerium), Hannover;
- Ministria e Drejtësisë e Landit Renania Veriore-Vestfali (Justizministerium des Landes Nordrhein-Westfalen), Düsseldorf;
- Ministria e Drejtësisë dhe për Mbrojtjen e Konsumatorëve e Landit Rheinland-Pfalz (Ministerium der Justiz und für Verbraucherschutz des Landes Rheinland-Pfalz), Mainz;
- Ministria e Drejtësisë e Saarland-it (Ministerium der Justiz des Saarlandes), Saarbrücken ;
- Ministria e Shtetit e Drejtësisë dhe Çështjeve Evropiane e Saksonisë (Sächsisches Staatsministerium der Justiz und für Europa), Dresden (;
- Ministria e Drejtësisë dhe Barazisë Gjinore e Landit Sachsen-Anhalt (Ministerium für Justiz und Gleichstellung des Landes Sachsen-Anhalt), Magdeburg;

- Ministria e Drejtësisë, Kulturës dhe Çështjeve Evropiane e Landit Schleswig-Holstein (Ministerium für Justiz, Kultur und Europa des Landes Schleswig-Holstein) Kiel;
- Ministria e Drejtësisë e Tiringisë (Thüringer Justizministerium), Erfurt;
- Gjykatat e Larta Rajonale (Oberlandesgerichte);
- Gjykatat Rajonale (Landgerichte);
- Gjykatat Lokale (Amtsgerichte);
- Kryeprokurori publik pranë gjykatave të larta rajonale (Generalstaatsanwaltschaften bei den Oberlandesgerichten);
- Drejtori i Prokurorive Publike pranë Gjykatave rajonale (Staatsanwaltschaften bei den Landgerichten);
- Zyra Qëndrore e Administratave Gjyqësore të Landit për hetimin e krimeve nacionalsocialiste (Zentrale Stelle der Landesjustizverwaltungen zur Aufklärung nationalsozialistischer Verbrechen), Ludwigsburg;

SHTOJCA IV

Kushtet sipas nenit 2 paragrafi 4

Duke iu referuar deklarimeve dhe kushtëzimeve të bëra gjegjësisht të shfaqura nga Republika Federale e Gjermanisë lidhur me Konventën Evropiane të datës 13 dhjetor 1957 për Ekstradim në rast se Republika Federale e Gjermanisë është Pala e kërkuar, dispozitat e Konventës dhe Protokollit të Dytë Shtesë të datës 17 mars 1978, të përcaktuara në Nenin 2, paragrafi 2 zbatohen në kushtet e mëposhtme:

1. Ekstradimi i një gjermani nga Republika Federale e Gjermanisë në një vend të huaj nuk është e lejuar në bazë të nenit 16, paragraf 2, fjalia e parë, të Ligjit Themelor të Republikës Federale të Gjermanisë, prandaj do të refuzohet në çdo rast.
2. Termi "shtetas" në kuptimin e nenit 6, paragraf 1 (b) i Konventës Evropiane për Ekstradim përfshin të gjithë shtetasit gjermanë në kuptimin e nenit 116, paragraf 1, të Ligjit Themelor të Republikës Federale të Gjermanisë.
3. Kalimi transit i një shtetasi gjerman përmes territorit të Republikës Federale të Gjermanisë (neni 21, paragraf 2 i Konventës për Ekstradim) nuk lejohet në bazë të nenit 16, paragraf 2, fjalia e parë, të ligjit Themelor të Republikës Federale të Gjermanisë, prandaj do të refuzohet në çdo rast.
4. Kur kalimi tranzit kryhet në rrugë ajrore, në përputhje me nenin 2, paragraf 3, do të kërkohet garancia që, në bazë të fakteve të njohura për Palën kërkuese dhe dokumentet në posedim të saj, personi i transferuar nuk ka shtetësinë gjermane dhe as nuk pretendon një status të tillë ligjor.

SHTOJCA V

Kushtet sipas nenit 2 paragrafi 4

Në rast se Republika e Kosovës është Pala e kërkuar, dispozitat e Konventës Evropiane të datës 13 dhjetor 1957 për Ekstradim dhe të Protokollit të Dytë Shtesë të datës 17 mars 1978, të specifikuara në nenin 2, paragrafi 2, zbatohen në kushtet e mëposhtme:

1. Republika e Kosovës do të refuzojë ekstradimin e shtetasve të saj.
2. Termi "Shtetas" i Republikës së Kosovës nënkupton çdo person që ka shtetësinë e Republikës së Kosovës në përputhje me ligjin në fuqi në Republikën e Kosovës.
3. Lidhur me Nenin 3 të Konventës Evropiane për Ekstradim, veprat penale politike nuk do të konsiderohen që përfshijnë kategoritë e mëposhtme të krimeve: gjenocid, krime kundër njerëzimit, krime të luftës dhe terrorizëm.
4. Duke iu referuar nenit 21, paragrafët 2 dhe 4 të Konventës për Ekstradim, kalimi transit i një shtetasi të Kosovës përmes territorit të Republikës së Kosovës nuk lejohet në bazë të Ligjit për Bashkëpunim Ndërkombëtar Ligjor në Çështjet Penale.
5. Kur kalimi transit kryhet në rrugë ajrore përmes territorit të Republikës së Kosovës, në përputhje me nenin 2 paragrafi 3, do të kërkohet garanci për faktin që, në bazë të fakteve të njohura për Palën kërkuese dhe dokumentet në posedim të saj, personi i transferuar nuk është shtetas i Kosovës dhe nuk pretendon një status të tillë.

SHTOJCA VI

Kushtet sipas Nenit 5 paragraf 4

Duke iu referuar deklarimeve dhe kushtëzimeve të shfaqura gjegjësisht të bëra nga Republika Federale e Gjermanisë në Konventën Evropiane të datës 21 mars 1983 për Transferimin e Personave të Dënuar, në rast se Republika Federale e Gjermanisë është Pala e kërkuar, dispozitat e Konventës për Transferimin e Personave të Dënuar dhe të Protokollit Shtesë të datës 18 dhjetor 1997, të specifikuara në Nenin 5, paragraf 2, zbatohen në kushtet e mëposhtme:

1. Në përputhje me preambulën e Konventës mbi Transferimin e Personave të Dënuar, Republika Federale e Gjermanisë niset nga mendimi se zbatimi i kësaj Konvente duhet t'i shërbejë jo vetëm rehabilitimit social të dënuarve, por edhe qëllimeve të ushtrimit të drejtësisë. Prandaj ajo do të marrë vendimin për transferimin e personave të dënuar në çdo rast individual në bazë të të gjitha qëllimeve ndëshkuese që burojnë në të drejtën e saj penale.
2. Republika Federale e Gjermanisë e interpreton Konventën Evropiane për Transferim të Personave të Dënuar ashtu që kjo Konventë formulon të drejta dhe detyrime vetëm ndërmjet Palëve dhe që nga kjo nuk dalin pretendime apo të drejta subjektive për personat e dënuar as nuk kanë nevojë për t'u arsyetuar pretendime apo të drejta të tilla (Neni 2, paragraf 2, fjalia e dytë, i Konventës për Transferim të Personave të Dënuar).
3. Republika Federale e Gjermanisë do të marrë përsipër ekzekutimin e dënimeve në përputhje me Konventën vetëm me kusht (neni 3, paragraf 1 i Konventës Evropiane për Transferim të Personave të Dënuar) që:

a) dënimi është shqiptuar në një gjykim në përputhje me Konventën për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore (Konventa e Këshillit të Evropës ETS Nr. 005 e datës 4 nëntor 1950) dhe protokollet e saj shtesë që janë në fuqi në Republikën Federale të Gjermanisë,

b) asnjë aktgjykim ose vendim që ka efekt të ngjashëm ligjor nuk është shqiptuar kundër personit të ndjekur penalisht për të njëjtën vepër penale në Republikën Federale të Gjermanisë,

c) ekzekutimi i dënimit nuk është i parashkruar sipas ligjit në fuqi në Republikën Federale të Gjermanisë për shkak të parashkrimit ose nuk do të parashkrohej në mënyrë të ngjashme pas konvertimit analog të fakteve.

4. Republika Federale e Gjermanisë do të transferojë ekzekutimin e vendimeve në përputhje me Konventën Evropiane për Transferimin e Personave të Dënuar tek Republika e Kosovës vetëm nëse është e garantuar që:

a) personi i dënuar do të ndiqet penalisht, do të dënohet, do të mbahet në arrest për ekzekutimin e një dënimi ose si masë korrigjuese dhe siguroese, ose do t'i nënshtrohet ndonjë kufizimi tjetër të lirisë së tij personale në lidhje me një vepër penale tjetër nga ajo e transferimit dhe e kryer para dorëzimit, vetëm në rast se:

aa) Republika Federale e Gjermanisë pajtohet, apo

bb) personi i transferuar nuk është larguar nga territori i shtetit zbatues brenda 45 ditëve nga lirimi i tij përfundimtar edhe pse ka pasur mundësi për ta bërë këtë, ose nëse, pasi është larguar nga ai territor është kthyer atje, dhe

b) shteti zbatues nuk do ta ndjekë përsëri ose të ekzekutoj një dënim të ri sa i përket veprës penale për të cilën është shqiptuar aktgjykimi.

5. Republika Federale e Gjermanisë do të marrë përsipër ekzekutimin e dënimeve vetëm me kusht që (neni 3, paragraf 3 i Konventës Evropiane për Transferim të Personave të Dënuar) një gjykatë gjermane deklaron se vendimi që është shqiptuar në shtetin dënues

është i ekzekutueshëm. Në shqyrtimin nëse kushtet për pranimin e ekzekutimit janë përmbushur, gjykata do të procedojë nga faktet dhe përfundimet juridike të përcaktuara në vendim.

6. Termi "shtetas" (Neni 3, paragraf 4 i Konventës Evropiane për Transferim të Personave të Dënuar) përfshin të gjithë gjermanët sipas nenit 116 paragraf 1 të Ligjit Themelor të Republikës Federale të Gjermanisë.

7. Republika Federale e Gjermanisë heq dorë nga informacionet dhe lajmërimet e parashikuara në nenin 4 paragrafët 2 deri 5 të Konventës Evropiane për Transferim të Personave të Dënuar, në qoftë se, sipas mendimit të autoriteteve kompetente gjermane, një kërkesë për ndihmë lidhur me ekzekutim përjashtohet a priori. Ajo nisët nga mendimi se një detyrim për të informuar personat e dënuar ekziston vetëm kur është në përputhje me dispozitat përkatëse të së drejtës brendashtetërore dhe se, veçanërisht, personi i dënuar nuk ka të drejtë të informohet në lidhje me procedura të brendshme zyrtare.

8. Në përputhje me të drejtën në fuqi në Republikën Federale të Gjermanisë, pëlqimi (neni 7, paragraf 1 i Konventës Evropiane për Transferim të Personave të Dënuar) nuk mund të tërhiqet.

9. Autoritetet e Republikës Federale të Gjermanisë do të marrin masa për të vazhduar ekzekutimin e dënimit (neni 8, paragraf 1 i Konventës për Transferim të Personave të Dënuar) nëse, dhe në momentin që personi i dënuar arratisët nga burgu apo në një mënyrë tjetër i shmanget vuajtjes së dënimit pasi autoritetet e shtetit zbatues kanë marrë atë përsipër dhe para se ekzekutimi i dënimit ka përfunduar. Prandaj, nëse personi i dënuar është gjetur në territorin e Republikës Federale të Gjermanisë para skadimit të gjysmës së kohës së mbetur për të vuajtur dënimin e shqiptuar apo konvertuar në shtetin zbatues, ata do të supozojnë se ai ka ikur dhe do ta ndalojnë atë për marrje të mëtejshme në pyetje, me përjashtim të rasteve kur shteti zbatues, përveç asaj që parashikohet në nenin 15 të Konventës Evropiane për Transferim të Personave të Dënuar, ka përguar informacionin se

personi i dënuar është liruar me kusht ose që ekzekutimi i dënimit është ndërprerë për arsye të tjera.

10. Duke pasur parasysh strukturën federale të Republikës Federale të Gjermanisë dhe faktin se Landet kanë kompetencë në fushën e vendimeve lidhur me faljen (neni 12 i Konventës Evropiane për Transferim të Personave të Dënuar), Republika Federale e Gjermanisë rezervon të drejtën për të transferuar ekzekutimin e vendimeve tek Republika e Kosovës në përputhje me Konventën Evropiane për Transferim të Personave të Dënuar vetëm me kusht që, në bazë të një deklaratë të përgjithshme ose të lidhur me ndonjë rast të veçantë nga ana e shtetit zbatues, falja do të ofrohet në shtetin zbatues vetëm në marrëveshje me autoritetin falës gjerman.

11. Republika Federale e Gjermanisë deklaron se kalimi transit i një personi të dënuar do të refuzohet nëse paraqiten kushtet e parashikuara në nenin 16 paragraf 2 a) dhe b) të Konventës Evropiane për Transferim të Personave të Dënuar zbatohen. Kur kalimi transit kryhet në rrugë ajrore, në përputhje me Nenin 5, paragraf 3, do të kërkohet garancia që, në bazë të fakteve të njohura për Palën kërkuese dhe dokumentet në posedim të saj, personi i transferuar nuk është shtetas gjerman dhe nuk pretendon një status të tillë ligjor.

SHTOJCA VII

Kushtet sipas Nenit 5 paragraf 4

Në rast se Republika e Kosovës është Pala e kërkuar, dispozitat e Konventës Evropiane të datës 21 mars 1983 për Transferim të Personave të Dënuar dhe Protokollit Shtesë të datës 18 dhjetor 1997, të specifikuara në nenin 5, paragraf 2, zbatohen me kushtet e mëposhtme:

1. Në përputhje me preambulën e Konventës për Transferimin e Personave të Dënuar, Republika e Kosovës niset nga mendimi se zbatimi i kësaj Konvente duhet t'i shërbejë jo vetëm rehabilitimit social të të dënuarve, por edhe qëllimeve të ushtrimit të drejtësisë. Prandaj ajo do të marrë vendimin për transferimin e personave të dënuar në çdo rast individual në bazë të të gjitha qëllimeve ndëshkuese që burojnë në të drejtën e saj penale.

2. Termi "Shtetas" i Republikës së Kosovës nënkupton çdo person që ka shtetësinë e Republikës së Kosovës në përputhje me ligjin në fuqi në Republikën e Kosovës.

3. Republika e Kosovës do të marrë përsipër ekzekutimin e dënimeve në përputhje me Konventën vetëm me kusht (neni 3, paragrafi 1 i Konventës Evropiane për Transferim të Personave të Dënuar) që:

a) dënimi është shqiptuar në një gjykim sipas Konventës për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore (Konventa e Këshillit të Evropës ETS Nr. 005 e datës 4 nëntor 1950) dhe protokollet e saj shtesë që mund të jenë në fuqi në Republikën e Kosovës,

b) asnjë aktgjykim ose vendim që ka efekt të ngjashëm juridik nuk është shqiptuar në Republikën e Kosovës për të njëjtën vepër penale kundër personit të transferuar,

c) ekzekutimi i dënimit nuk është i parashkruar sipas ligjit të aplikueshëm në Republikën e Kosovës për shkak të parashkrimit ose nuk do të parashkrohej në mënyrë të ngjashme pas konvertimit analog të fakteve.

4. Republika e Kosovës do të transferojë ekzekutimin e dënimeve në përputhje me Konventën Evropiane për Transferimin e Personave të Dënuar tek Republika Federale e Gjermanisë, vetëm nëse është e garantuar që:

a) personi i dënuar do të ndiqet penalisht, do të dënohet, do të mbahet në arrest për ekzekutimin e një dënimi ose si masë korigjuese dhe siguroese, ose do t'i nënshtrohet ndonjë kufizimi tjetër të lirisë së tij personale në lidhje me një veprë penale tjetër nga ajo e transferimit dhe e kryer para dorëzimit, vetëm në rast se:

aa) Republika e Kosovës pajtohet, ose

bb) personi i transferuar nuk është larguar nga territori i shtetit zbatues brenda 45 ditëve nga lirimi i tij përfundimtar edhe pse ka pasur mundësi për ta bërë këtë, ose nëse, pasi është larguar nga ai territor, është kthyer atje,

dhe

b) shteti zbatues nuk do ta ndjekë penalisht përsëri ose të zbatojë një dënim të ri sa i përket veprës penale për të cilën është shqiptuar aktgjykimi.

5. Duke iu referuar Neneve 9 dhe 11 të Konventës Evropiane për Transferim të Personave të Dënuar, autoritetet e Republikës së Kosovës do të ekzekutojnë dënimin në përputhje me procedurën e paraparë nga e drejta brendashtetërore.

6. Republika e Kosovës rezervon të drejtën për të transferuar ekzekutimin e vendimeve tek Republika Federale e Gjermanisë në përputhje me Konventën Evropiane për Transferimin e Personave të Dënuar vetëm me kusht që, në bazë të një deklaratë të përgjithshme ose të

lidhur me ndonjë rast të veçantë nga shtetit zbatues, falja do të ofrohet në Shtetin zbatues vetëm në marrëveshje me Presidentin e Republikës së Kosovës.

7. Republika e Kosovës deklaron se kalimi transit i një personi të dënuar do të refuzohet nëse paraqiten kushtet në nenin 16 paragraf 2 a) dhe b) të Konventës Evropiane për Transferim të Personave të Dënuar. Kur kalimi transit kryhet në rrugë ajrore, në përputhje me Nenin 5, paragraf 3, do të kërkohet garancia që, në bazë të fakteve të njohura për Palën kërkuese dhe dokumentet në posedim të saj, personi i transferuar nuk është shtetas i Kosovës dhe nuk pretendon një status të tillë ligjor.